



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 18, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "TIRANA EAST TOWER RESIDENCE", STRUKTURË SHËRBIMI, BANIMI DHE HOTELERIE ME 2, 3, 34, 35 DHE 36 KATE MBI TOKË, ME 6 KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN "GRAMOZ PASHKO", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Geo Construction" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Tirana East Tower Residence", Strukturë shërbimi, banimi dhe hotelerie me 2, 3, 34, 35 dhe 36 kate mbi tokë, me 6 kate nëntokë, me vendndodhje në Rrugën "Gramoz Pashko", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Geo Construction" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Vendimi Nr. 28, datë 01.08.2023 "Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Tirana East Tower", me vendndodhje në Rrugën "Gramoz Pashko", Bashkia Tiranë", shfuqizohet.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 07/03/2025